



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.1314/15

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Kujtesa Uka, në kontestin e paditësve H. H., A. H., B. H.1, B. H.2, A. G., Xh. H., N. H., E. H. dhe F. H., të gjithë nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av.Xh. B. nga Prishtina, kundër të paditurës K.S.”Kosova e re” - Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën **25.07.2016**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve H. H., A. H., B. H.1, B. H., A. G., Xh. H., N. H., E. H. dhe F. H., të gjithë nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, dhe **obligohet** e paditura K.S.”Kosova e re” nga Prishtina, që në emër të dëmit jo material, t’ia kompensojë paditësve shumat si në vijim:

- a). Paditësve **H. H.** dhe **A. H.**, të dy nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit:
 - në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditetit tejet të rëndë të djalit të tyre, secilit shumën prej nga 5,000.00 euro;
- b). Paditësve **B.1** dhe **B. H.2**, të dy nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit:
 - në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditetit tejet të rëndë të vëllaut të tyre, secilit shumën prej nga 3,000.00 euro;
- c). Paditëses **A. G.** nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit:
 - në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditetit tejet të rëndë të bashkëshortit jashtëmartesor të saj, shumën prej 7,000.00 euro;
- d). Paditësve **Xh. H., N. H., E. H. dhe F. H.**, të gjithë nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit:
 - në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditetit tejet të rëndë të babait të tyre, secilit shumën prej nga 6,000.00 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej **47,000.00 euro**, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi

(25.07.2016), e deri te pagesa definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

II. Obligohet e paditura që t'ia paguajë shpenzimet procedurale paditësve dhe atë në lartësi prej **3,724.00 euro**, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarrimit me dhunë.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën **I** të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar prej **70,000.00 euro**, **refuzohet si e pa bazuar**.

A r s y e t i m

Paditësit H. H., A. H., B. H.1, B. H.2, A. G., Xh. H., N. H., E. H. dhe F. H., të gjithë nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av.Xh. B. nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, kundër të paditurës K.S."Kosova e re" nga Prishtina, duke theksuar se me datën 31.07.2014, rreth orës 17:00 minuta, në rrugën Prishtinë-Prizren (në autostradë), është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, ku lëndime të rënda trupore me shëmtim, zvogëlim të aktivitetit jetësor, kaësuar S. H. - djali, vëllai, bashkëshorti dhe babai i paditësve, të cilat lëndime janë vërtetuar në ekspertizën mjekësore të bërë në Gjykatën Themelore në Prizren, në lëndën C.nr.1061/14 nga ana e ekspertëve. Si pasojë e aksidentit i dëmtuari S. H. ka pasur lëndime të rënda trupore, shëmtim, zvogëlim të aktivitetit jetësor - invaliditet në shkallë prej 65 % (ku si pasojë e aksidentit i njëjti lëviz me karrocë të personave me aftësi të kufizuar), andaj siç parashihet në dispozitat e nentit 184 par.3 të LMD-së, paditësit kanë përjetuar dhimbje shpirtërore, pasi që të njëjtit kanë afërsi familjare me të dëmtuarin. Automjeti me përdorimin e të cilit është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar tek kompania e sigurimit "Kosova e re" nga Prishtina, (i dëmtuari ka qenë në cilësinë e bashkëudhëtarit). Andaj në padi përmes të autorizuarit të tyre, kanë propozuar që gjykata të nxjerr provat dhe të obligojë të paditurën që t'ia kompenzojë dëmin jomaterial në shumë të përgjithshme, e cila do të precizohet pas marrjes së mendimit të ekspertit të psikiatrisë si dhe shpenzimet procedurale.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësve av.Xh. B. nga Prishtina, kryesisht ka ngelur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa me parashtrësën e datës 08.07.2016 pas marrjes së mendimit të ekspertit të psikiatrisë ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar vlerat si në vijim: për paditësin H. H. - në emër të dhimbjeve shpirtërore për invaliditetin e rëndë të të birit, shumën prej 8,000.00 euro, A. B. - në emër të dhimbjeve shpirtërore për invaliditetin e rëndë të të birit, shumën prej 8,000.00 euro, B. H.1 dhe B. H.2 - në emër të dhimbjeve shpirtërore për invaliditetin e rëndë të vëllait të tyre secilit shumën prej nga 6,000.00 euro, A. G. - në emër të dhimbjeve shpirtërore për invaliditetin e rëndë të bashkëshortit të saj, shumën prej 10,000.00 euro, Xh. H., N. H., E. H. dhe F. H. - në emër të dhimbjeve shpirtërore

për invaliditetin e rëndë të babait të tyre, secilit shumën prej nga 8,000.00 euro. Në fjalën e fundit ka theksuar se në bazë të provave të administruara, nuk është kontestuese së familjari i paditësve me rastin e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore me zvogëlim të aktivitetit jetësor 65 % si dhe forma tjera të dëmit. Për dhimbjet shpirtërore që kanë pësuar paditësit është nxjerrë ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë, andaj i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar, si në precizimin e saj të datës 08.07.2016. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: për përpilimin e padisë 416.00€, në emër të taksës gjyqësore 26€, në emër të shpenzimeve të ekspertit të psikiatrisë 250€, në emër të përfaqësimit për 5 seanca nga 810.00 euro dhe për precizimin e kërkesëpadisë 416.00 euro.

Përmes përgjegjës me shkrim në padi, e paditura K.S.”Kosova e re” nga Prishtina, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë si për nga baza juridike ashtu edhe për nga lartësia për dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar në aksidentin e datës 31.07.2014, duke kërkuar prova shtesë për tu deklaruar më hollësisht.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, e autorizuar e të paditurës ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjës me shkrim ndaj padisë duke e kontestuar pjesërisht kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, ndërsa në fjalën e fundit ka theksuar se mbetet pranë përgjigjes në padi, duke e kontestuar në tërësi kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Për nga baza për arsye se nuk është vërtetuar me aktgjykim fajësia e të siguarit të paditurës, ndërsa për nga lartësia për arsye se shumatat e kërkuara janë të larta. Poashtu ka theksuar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve B.1 dhe B. H.2, për arsye se është në kundërshtim me nenin 184.3 të LMD-së. Gjithashtu ka kundërshtuar edhe lartësinë dhe afatin e llogaritjes së kamatës. Sa i përket shpenzimeve ka propozuar që për të njëjtat të vendoset sipas suksesit në procedurë.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka zhvilluar procedurën dhe me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka administruar provat si në vijim: Raportin e aksidentit së bashku me skicën e vendit, nr.2014-TR-0105, të datës 31.07.2014; Deklaratën e bashkësisë familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prizren, të datës 28.10.2015; Ekstraktet e lindjes për A. G., Xh. H., N. H., E. H. dhe F. H., të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prizren, të datës 27.10.2015; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1061/14 të datës 20.01.2016 si dhe është marrë mendimi i ekspertit të psikiatrisë dr.N. F. nga Prizreni.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Pas vlerësimit të provave të administruara gjykata konstatojë se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se me datën 31.07.2014, rreth orës 17,00 minuta, në

rrugën Prishtinë-Prizren, në autostradë, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit dhe që në këtë aksident lëndime të rënda trupore me invaliditet të rëndë ka pësuar familjari i këtu paditësve S. H..

Në mes palëve ndërgjyqëse ka qenë kontestuese baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë. Baza juridike me arsyetimin se nuk ekziston aktgjykim i plotëfuqishëm lidhur me shkaktarin e aksidentit. Mirëpo nga provat e administruara, e sidomos nga Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1061/14 të datës 20.01.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu e paditura në këtë procedurë ka pranuar bazën juridike të kërkesëpadisë duke ia ofruar si ofertë palës paditëse një shumë të caktuar, andaj edhe gjykata nuk ka marrë prova tjera lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë (pasi që edhe kjo nuk është propozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse). Andaj sipas gjykatës nuk është kontestues fakti se automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti si pasojë e të cilit ka pësuar lëndime të rënda trupore familjari i paditësve S. H., ka qenë i siguruar te kompania e sigurimit “Kosova e re” dhe për këtë e njëjta ka legjitimacion real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë.

Poashtu nga provat materiale të administruara gjykata konstatojë se nuk është kontestues fakti se i dëmtuari S. H. nga familjarët e tij të ngushtë ka prindërit e tij H. dhe A. H., vëllezërit B.2 dhe B. H.2, bashkëshorten jashtëmartesore A. G. si dhe fëmijët Xh. H., N. H, E. H. dhe F. H., të cilin fakt gjykata e vërtetojë me shikimin në certifikatat e lindjes së paditësve ndërsa nga deklarata e bashkësisë familjare e datës 28.10.2015, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësit kanë jetuar në bashkësi familjare me të dëmtuarin S. H. dhe për këtë të njëjtit kanë legjitimacion real aktiv për të qenë palë në këtë procedurë.

Baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses gjen mbështetje në dispozitat e nenit 136, 137, 159, 177 par.1, 183 par.1 dhe 184 par.3 dhe 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

Me nenin 136 al.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve - LMD, (Nr. 04/L-077), i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të aksidentit është paraparë se **“kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”**, ndërsa me nenin 137 të po këtij ligji është paraparë se **“Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zykonshtëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkatimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”**. Poashtu me nenin 159 par.1 të LMD-së parashihet se **“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi, zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajitë”**. Në nenin 177 par.1 të këtij ligji parashihet se **“Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që ti shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij”**. Poashtu në nenin 183 par. 1 të këtij ligji parashihet se **“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cënimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personatit, të vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe**

nga mungesa e dëmit material”, ndërsa në par.2 të po këtij neni është paraparë se “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cënimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë se me të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Me nenin 184 par.3 të LMD-së ku në mënyrë decisive ceket se “Në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund tu caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore”., ndërsa në par.4 të këtij neni ceket se “Shpërblimi nga paragrafi 1. Dhe 3. I këtij neni mund t'i caktohet edhe bashkëshortit jashtëmartesor në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme”.

Pas vlerësimit të gjendjes faktike të cekur më lartë gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar në ligj dhe fakte.

Nga raporti policor i aksidentit me nr. 2014-TR-0105, të datës 31.07.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se me datën 31.07.2014, rreth orës orës 17:00 minuta në rrugën Prishtin-Prizren, në autostradë (km 58), vozitësi S. E. nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, i cili ishte duke vozitur automjetin e tij të tipit “Opel” me targa *numri i targës...*, si pasojë e vozitjes së pakujdesshme, duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe gjendjes së rrugës, pasi që kishte punime në rrugë, nga pakujdesia frenon vullshëm dhe kalon në shiritin e kundërt të lëvizjes duke e goditur automjetin e markës “Nissan” me targa *numri i targës...*, i cili ishte duke e lëvizur në shiritin e kundërt, me ç'rast lëndime të rënda me invaliditet tejet të rëndë pësoni dëmtuari S. H.. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti, i markës “Opel” me targa *numri i targës...*, në momentin e shaktimit të këtij aksidenti, ka qenë i siguar tek këtu e paditura K.S. “Kosova e re” me seli në Prishtinë.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1061/14 të datës 20.01.2012, gjykata vërtetoi faktin se është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësve S. dhe B. H.2 dhe është obliguar e paditura K.S. “Kosova e re” – Prishtinë, që të ua kompensojë dëmin material dhe jomaterial në emër të dhimbjeve fizike, shëmtimit dhe formave tjera të dëmit.

Edhe pse nuk është kontestuese së me rastin invaliditetit tejet të rëndë të anëtarit të ngushtë të familjes, anëtarët tjerë të familjes (këtu paditësit) përjetojnë dhimbje shpirtërore, gjykata ka angazhuar ekspertin e lëmisë psikiatrike Dr.N. F., i cili duke bazuar në dokumentacionin mjekësor i cili ekziston në bazë të shkresave të lëndës si dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësve ka dhënë mendimin e tij me shkrim duke deklaruar se paditësit H. dhe A. H. si prindër të të dëmtuarit S. H. kanë përjetuar dhimbje shpirtërore të intenzitetit të lartë, e cila ka qenë prezente 3 muaj (që pas aksidentit të djalit), sa herë përballen me pasojat që i ka shkaktuar dëmtimi në aspektin e aftësisë së zvogëluar jetësore dhe punuese si dhe shëmtimit trupor. Sidomos kanë pësuar shok emocional që nga marrja e lajmit të parë dhe kur e kanë parë në spital gjatë intervenimeve mjekësore. Kjo dhimbje është mbajtur e fortë edhe për shkak të brengosjeve të shumta dhe pasigurisë lidhur me rrjedhën e mjekimit. Po ashtu kanë përjetuar

edhe dhimbje shpirtërore të intenzitetit të ulët, e cila është prezente ende për shkak se dëmtimi është definitiv tek djali. Kjo sidomos aktivizohet sa herë ballafaqohen me paaftësinë e tij në disa sfera të funksionimit të përditshëm si kujdesi ndaj vetes, pjesëmarrja në takime familjare dhe publike pamundësia e përfshirjes në aktivitete të lidhura me edukimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve etj. Nevoja ende prezente për intervenime mjekësore e lidhur edhe me mundësitë e kufizuara finaciare është goditëse psikologjike në këtë periudhë dhe për këtë edhe kanë përdorur barëra qetësuese e paditësi H. H. ka edhe probleme me zemër. Paditësja A. G. si bashkëshorte e të dëmtuarit S. H. kanë përjetuar dhimbje shpirtërore të intenzitetit të lartë, e cila ka qenë prezente 6 muaj (që pas aksidentit të bashkëshortit), sa herë përballlet me pasojat që i ka shkaktuar dëmtimi në aspektin e aftësisë së zvogëluar jetësore dhe punuese si dhe shëmtimit trupor. Sidomos kanë pësuar shok emocional që nga marrja e lajmit të parë dhe kur e kanë parë në spital gjatë intervenimeve mjekësore. Kjo dhimbje është mbajtur e fortë edhe për shkak të brengosjeve të shumta dhe pasigurisë lidhur me rrjedhën e mjekimit. Po ashtu kanë përjetuar edhe dhimbje shpirtërore të intenzitetit të ulët, e cila është prezente ende për shkak se dëmtimi është definitiv tek bashkëshorti. Kjo sidomos aktivizohet sa herë ballafaqohet me paaftësinë e tij në disa sfera të funksionimit të përditshëm si kujdesi ndaj vetes, pjesëmarrja në takime familjare dhe publike pamundësia e përfshirjes në aktivitete të lidhura me edukimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve etj. Nevoja ende prezente për intervenime mjekësore e lidhur edhe me mundësitë e kufizuara finaciare është goditëse psikologjike në këtë periudhë dhe për këtë edhe kanë përdorur barëra qetësuese. Sa i përket paditësve Xh. H., N. H., E. H. dhe F. H. si fëmijë të dëmtuarit S. H. kanë përjetuar dhimbje shpirtërore të intenzitetit të lartë, e cila ka qenë prezente 3 muaj (që pas aksidentit të babait), në fillim me mungesën fizike dhe emocionale (qëndrimi në spital dhe kontrolllet e shpeshta mjekësore). Po ashtu kanë përjetuar edhe dhimbje shpirtërore të intenzitetit të ulët, e cila është prezente ende për shkak se dëmtimi është definitiv tek babai. Kjo është manifestuar në formë të zvogëlimit të aftësisë së përkujdesjes dhe afërsisë emocionale, e cila për shkak të vështirësive fizike dhe emocionale të babait që nga aksidenti është zvogëluar në aspektin cilësor. Sidomos fëmijët që janë në shkollë e kanë të vështirë kur babai nuk është në gjendje ti mbështesë në disa kativitete që kanë të bëjnë me shkollën (mungesa në mbledhjen e prindërve, ngucatjet nga fëmijët tjerë), e cila ka ndikuar edhe me rënien në mësim në disa periudha. Sa i përket paditësve B.1 dhe B. H.2 si vëllezër të të dëmtuarit S. H. kanë përjetuar dhimbje shpirtërore të intenzitetit të lartë, e cila ka qenë prezente 1 muaj (që pas aksidentit të vëllaut), sa herë përballen me pasojat që i ka shkaktuar dëmtimi në aspektin e aftësisë së zvogëluar jetësore dhe punuese si dhe shëmtimit trupor. Sidomos kanë pësuar shok emocional që nga marrja e lajmit të parë dhe kur e kanë parë në spital gjatë intervenimeve mjekësore. Kjo dhimbje është mbajtur e fortë edhe për shkak të brengosjeve të shumta dhe pasigurisë lidhur me rrjedhën e mjekimit. Po ashtu kanë përjetuar edhe dhimbje shpirtërore të intenzitetit të ulët, e cila është prezente ende për shkak se dëmtimi është definitiv tek vëllau. Kjo sidomos aktivizohet sa herë ballafaqohen me paaftësinë e tij në disa sfera të funksionimit të përditshëm si kujdesi ndaj vetes, pjesëmarrja në takime familjare dhe publike, pamundësia e përfshirjes në aktivitete të lidhura me edukimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve etj. Nevoja ende prezente për intervenime mjekësore e lidhur edhe me mundësitë e kufizuara finaciare është shumë goditëse psikologjike

në këtë periudhë. Konstatimit të tillë të ekspertit psikiatër Dr. N. F., kjo gjykatë ia fali besimin, pasi që mendimi i tij është dhënë në mënyrë profesionale dhe objektive.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara e sidomos mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjekësor Dr.N. F. -psikiatër, e të ciit mendim gjykata në tërësi ia fali besimin, pasi që mendimi i tij është dhanë në mënyrë profesionale dhe objektive dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar ashtu siç është aprovuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që lartësia e aprovuar në emër të dëmit jo material është adekuate me dhimbjet shpirtërore të pësura të paditësve, e të cilat gjykata i caktoi sipas bindjes së lirë konform nenit 323 të LPK-së si dhe duke pasur si orientim kriteret dhe masat e përcaktimit të lartësisë së dëmeve jo materiale të përcaktuara nga kompanitë e sigurimeve.

Nga të lartcekurat dhe duke marr parasysh rrethanat e rastit konkret gjykata konstatojë se paditësit kanë përjetuar dhimbje shpirtërore të intenzitetit të lartë për shkak të lëndimit - invaliditetit tejet të rëndë të djalit, vëllaut, bashkëshortit jashtëmator, përkatësisht babait të tyre, tani të lënduarit S. H. dhe të njëjtëve ju takon e drejta e kompensimit të dëmit jo material e cila mund të jetë një formë e satifikacionit moral për këtu paditësit.

Gjykata pasi konstatoi të gjitha rrethanat e rastit dhe duke pasur parasysh dhimbjet e pësura shpirtërore e sidomos intensitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve, pastaj mënyrën e manifestimit të saj me ankth, shqetësim, brengosje, mërziqe për invaliditetin e birit, vëllaut, bashkëshortit jashtëmator, përkatësisht babait të tyre dhe duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompenzimit siç janë praktika e mirë gjyqësore, pasojat (dhimbjet) e përhershme për anëtarët e ngushtë të familjes, moshë e re të lënduarit si dhe invaliditeti i tij në shkallë prej 65%, andaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompenzimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompenzim, e gjithashtu edhe faktin se me të njëjtin të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror.

Përfundimisht, Gjykata konsideron se lartësia e aprovuar në emër të kompenzimit të dëmit jo material është shpërblim real dhe objektiv e që e njëjta paraqet një formë të satisfaksionit që paditësit me këto mjete të plotësojnë nevojat dhe të mirat materiale që përndryshe nuk paraqesin kompenzim absolut të dëmit. Me rastin e vendosjes për lartësinë e kërkesëpadisë për të gjitha kategoritë e caktuara të dëmit jo material, gjykata vendosi në kuptim të nenit 184 par.3 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD ku në mënyre decidive ceket se ***“Në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund tu caktoj bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore”***, ndërsa në par.4 të këtij neni ceket se ***“Shpërblimi nga paragrafi 1. dhe 3. i këtij neni mund t'i caktohet edhe bashkëshortit jashtëmator në qoftë se***

ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme”.

Gjykata pretendimet e të autorizuarit të të paditurës të dhëna në fjalën përfundimtare se e konteston bazën juridike të kërkesëpadisë, pasi që nuk është vërtetuar me aktgjykim të plotëfuqishëm fajësia e të siguruarit të paditëses, i vlerësoi si të paqëndrueshme nga fakti se lidhur me këtë është zhvilluar procedura gjyqësore sipas lëndës C.nr.1061/14 dhe vet pala paditëse i ka ofruar paditësit ofertën në lartësi prej 25,000.00 euro për të gjitha llojet e dëmit, që sipas vlerësimit të gjykatës këtu pala e paditur e ka pranuar bazën juridike të kërkesëpadisë (pala e paditur ka mundur të kontestojë dhe të propozojë prova për këtë sipas kësaj lënde C.nr.1061/14, e cila është përfunduar me aktgjykim). *Është vlerësim i gjykatës se edhe pse pala e paditur e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë këtu i lënduari Salla Hoxhaj në aksidentin e datës 31.07.2014 ka qenë në cilësinë e personit të tretë dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi të njëjtit i takon kompensimi.* Gjithashtu gjykata edhe deklarimet e të autorizuarës së të paditurës se sa i përket paditësve B.1 dhe B. H.2 një kërkesë e tillë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 184 par. 3 të LMD-së, i vlerësoi si të pa qëndrueshme për shkak se këtu të paditurit si vëllezër të të lënduarit kanë përjetuar dhimbje të mëdha shpirtërore për shkak të invaliditetit tejet të rëndë të vëllaut të tyre, si dhe për faktin se të njëjtit ka jetuar dhe jetojnë në bashkësi familjare me të lënduarin S. H. dhe vazhdimisht përballen me pasojat të cilat i ka pësuar i njëjti në aksidentin e datës 31.07.2014, e që një qëndrim i tillë gjen mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi si dhe në praktikën gjyqësore.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumë mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë deliktore civile të të paditurës, respektivisht të ngasësit të automjetit i cili ka qenë i siguruar te këtu e paditura, në aksidentin në fjalë. Poashtu gjykata për pjesën refuzuese vendosi duke u bazuar edhe në mendimet e ekspertit mjekësor lidhur me shkallën e dhimbjeve të përjetuara shpirtërore te paditësve H. H., A. H. (prindërve të të lënduarit), B. H.1, B. H.2 (vëllezërve të të lënduarit), A. G. (bashkëshortes jashtëmartesore të të lënduarit) dhe Xh. H., N. H., E. H. dhe F. H. (fëmijëve të të lënduarit).

Gjykata e aprovoi kërkesëpadinë lidhur me kompensimin e dëmit sa i përket dhimbjeve shpirtërore të vëllezërve të të dëmtuarit S. H., pasi që vlerësoi se të njëjtin kanë jetuar në bashkësi familjare me të ndjerin (fakt i vërtetuar nga çertifikata e bashkësisë familjare) dhe për këtë kanë qenë të lidhur emocionalisht dhe kanë përjetuar dhimbje të mëdha shpirtërore (të cekura edhe në ekspertizën e ekspertit të psikiatrisë), lidhur me invaliditetin e vëllaut të tyre (vlen të ceket se në këtë drejtim shkon edhe praktika gjyqësore lidhur me këto raste).

Poashtu gjykata sa përket bashkëshortes jashtëmartesore e ka aprovuar kërkesëpadinë, pasi që ka gjetur se në mes saj dhe të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme (nga e cila kanë të lindur edhe katër fëmijë) dhe për këtë e njëjta ka përjetuar dhimbje të mëdha shpirtërore, ngase është përballur dhe përballlet çdo ditë me pasojat nga invaliditeti i

bashkëshortit të saj jashtëmartesor, dhe kjo e drejtë është e paraparë edhe me dispozitat ligjore të nenit 184 par.4 të LMD-së.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kamatën vjetore, gjykata vendosi konform nenit 382 të LMD-së, pasi që e paditura është vonuar në pagesën e detyrimit ndaj paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së si dhe sipas tarifës zyrtare të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë: për parashkrimin e padisë 208.00 euro, për 4 përfaqësime nga 810.00 euro, shpenzimet e ekspertizës mjekësore në shumë prej 250.00 euro, për taksa gjyqësore 26.00 euro, respektivisht shumën e tërësishme të shpenzimeve prej **3,724.00** euro, pasi që këto janë shpenzime proporcionale me suksesin e arritur në procesin gjyqësor dhe kanë qenë shpenzime të domosdoshme. Pjesën tjetër të shpenzimeve të kërkuara për një seancë tjetër të shtyrë dhe për padi dhe për precizimin e kërkesëpadisë, gjykata i refuzoi si të pa bazuara, pasi që të dy këto janë shkaktuar pa fajin e palës së paditur dhe janë në kundërshtim me tarifën zyrtare të odes së avokatëve.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.1314/15, datë 25.07.2016

Sekretarja juridike
Kujtesa Uka

Gjyqtari
Arsim Hamzaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.